



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI Nr. 2003 / 18

PËR SHËRBIMET POSTARE

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/9 të 15 Majit Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, veçanërisht nenet 5.1(h), 5.7,9.1.26(a), 9.3.3, dhe tutje

Me qëllim të zhvillimit të një shërbimi modern postar në Kosovë, të bazuar në ekonomi të tregut të lirë dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare,

Aprovon:

LIGJIN PËR SHËRBIMET POSTARE

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Lënda e rregullimit

Me këtë ligj rregullohet veprimtaria postare në Kosovë.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

1. Sigurimi i ofrimit të shërbimit univerzal postar në gjithë territorin e Kosovës.
2. Mbrojtja e interesave të shfrytëzuesve dhe sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të tyre.
3. Nxitja e konkurrencës së lirë dhe efektive në ofrimin e shërbimeve postare.
4. Nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit.
5. Sigurimi i sekretit të korrespondencës për shfrytëzuesin.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. "Shërbim postar" nënkuptohen shërbimet e kryera me pagesë për dërgimin e dërgesave të postës- letrave ose kolive të adresuara, në peshën deri në 20 kg secila. Gjithashtu, "shërbime postare" nënkuptohen edhe shërbimet e kryera me pagesë të cilat sigurohen nëpërmjet mjeteve për dërgimin e dërgesave postare.
2. "Shërbimi univerzale postar" nënkuptohen shërbimet e kryera me pagesë për dërgimin e dërgesave të thjeshta të postës, si të letrave deri në 2 kg, kolipostës së adresuar deri në 20 kg, shërbimet e urdhërpagesave postare dhe shërbimet për dërgesat e regjistruara me vlerë. Për koliposten e adresuar ndërkombëtare, që hynë nga shtete të tjera, kufiri i shërbimit univerzal shtrihet deri në 20 kg.
3. " Dërgesë postare" nënkuptohet çdo lloj dërgese, e dërguar nga operatori postar (letra, koliposta, urdhërpagesa postare etj.).
4. "Dërgim" nënkuptohet çdo veprimtari e parashikuar për përpunimin, dërgimin dhe dorëzimin e dërgesave postare tek marrësi.
5. " Dërgesa të postës së letrave" nënkuptohen letrat, kartpostalet, shtypshkrimet, literatura për të verbërit, paketat e vogla.
6. " Dërgesë e thjeshtë postare" nënkuptohet çdo dërgesë postare, që nuk shoqërohet me asnjë shërbim me vlerë, regjistrimet dhe shërbimet tjera të posaçme.
7. "Shërbim i veçantë" nënkupton shërbimin e regjistrimit, lajmërimarrjes, postës ajrore, shërbimin ekspres, pagimit në çastin e dorëzimit, të thyeshme, për t'iu dorëzuar vetëm marrësit.
8. "Shërbim me vlerë të shtuar" nënkupton shërbimet tjera që nuk përfshihen në shërbimet univerzale dhe shërbimet speciale, si dhe shërbimet e reja, përmbushja e të cilave realizohet nga ofruesi i shërbimit, sipas rregullave të tij të biznesit.
9. "Postë direkte" nënkuptohet një komunikim që ka të bëjë vetëm me material reklame ose marketingu dhe që përmban një mesazh identik, me përjashtim të emrit, adresës apo të të dhënave të tjera, të cilat nuk e ndryshojnë natyrën e mesazhit dhe që i dërgohet një numri të ndjeshëm personash.
10. "Agjent postar" nënkuptohet një person fizik ose juridik, i autorizuar për kryerjen e shërbimeve postare nga një ofrues i shërbimeve postare.
11. "Rrjet postar publik" nënkuptohet tërësia e lidhjeve teknike dhe të trafikut të zyrave të postës dhe të shërbimeve të transportit, vënë në interes të ofrimit të shërbimeve postare nga Operatori Publik i Postave.
12. "Treg postar" nënkuptohet tregu i shërbimeve postare të siguruara kundrejt pagesës.
13. "Operator publik i postave" nënkuptohet çdo person juridik që i ofron publikut shërbimet univerzale postare, sipas marrëveshjes së lidhur me Ministrin.

14. "Shërbime të rezervuara" nënkuptohen shërbimet e kryera ekskluzivisht nga Operatori Publik i Postave, për të përmbushur detyrimin e shërbimit univerzal dhe që kanë të bëjnë me pranimin, përpunimin, dërgimin dhe dorëzimin e dërgesave të korrespondencës së brendshme, me çmim më të lartë për 3,5 herë se sa tarifa publike për një dërgesë të korrespondencës për peshën më të vogël të kategorisë së standardeve më të shpejta, nëse ka kategori të tilla, duke siguruar që pesha e tyre të jetë më e vogël se 2 kg.
15. "Ofrues i shërbimit" nënkuptohet çdo person juridik apo fizik, i cili i ofron publikut shërbime postare.
16. "Shfrytëzues ose përdorues" nënkuptohet çdo person, fizik apo juridik, i cili përfiton nga ofrimi i shërbimeve postare si një dërgues ose marrës.
17. "Departamenti i Postës (DP)" nënkuptohet departamenti që udhëheq politikën dhe rregullimin e shërbimit postar pranë Ministrisë.
18. "Ministri" nënkuptohet Ministria për Transport dhe Postë-Telekomunikacion.
19. "Ministër" nënkuptohet Ministri i Ministrisë për Transport dhe Postë-Telekomunikacion.
- 20 "Buxheti" nënkupton buxhetin e konsoliduar të Kosovës.
21. "Kuti postare" nënkupton kutit postare të vendosura në vendet publike nga të cilat merren dërgesat postare.

Neni 4 Shfrytëzimi i shërbimeve postare

Të gjithë personat në Kosovë kanë të drejtë të shfrytëzojnë shërbimet postare, në mënyrë të barabartë në përputhje me dispozitat e këtij Ligji.

Neni 5 Shërbimi postar ndërkombëtar

Shërbimet postare ndërkombëtare realizohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të standardeve ndërkombëtare lidhur për shërbimet postare.

KREU II ROLI I MINISTRISË NË SEKTORIN POSTAR

Neni 6 Roli i Ministrisë

6.1. Ministria nëpërmjet Ministrit, përcakton politikën dhe strategjinë e zhvillimit të postave dhe bën rregullimin e sektorit postar në Kosovë.

6.2. Në lëmin e sektorit të postave Ministri:

1. I propozon Qeverisë strategjinë e zhvillimit të postave dhe ligjet që rregullojnë veprimtarinë postare.

2. Miraton procedurat për kryerjen e pagesave dhe dhënien e licensave për ushtrimin e veprimtarisë postare.
3. I propozon Qeverisë miratimin e tarifave postare për shërbimet univerzale dhe për shërbimet e rezervuara.
4. I propozon Qeverisë masa që sigurojnë kryerjen e shërbimit univerzal postar.
5. Nënshkruan marrëveshje me operatorin publik të postave për detyrat dhe treguesit që ai duhet të plotësojë për respektimin e detyrimeve për kryerjen e shërbimit univerzal.
6. Përfaqëson Ministrinë në organizatat ndërkombëtare të postave dhe nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e postave, në koordinim me UNMIK-un.

Neni 7

Departamenti i Postës

Departamenti i Postës i cili kryen edhe funksionin e Rregullatorit deri në vitin 2008 është në vartësi të Ministrisë dhe ushtron këto detyra:

1. Përcakton politikat e zhvillimit të shërbimit postar dhe siguron kushtet organizative për zbatimin e tyre, duke nxitur investimet në sektorin postar. Si organ rregullator ka për detyrë të veçante të sigurojë perputheshmeri të plote me obligimet që dalin nga direktivat e Bashkimit Europian, dhe aty ku është e domosdoshme duhet të ushtroje kontrole dhe procedura të veçanta për të siguruar që shërbimet e rezervuara të respektohen. Duhet të sigurojë konkurrence të ndershme dhe transparence në shërbimet postare
2. Propozon normativat dhe treguesit cilësor të shërbimeve postare dhe siguron veprimtarinë kërkimore dhe rekomandimet ndërkombëtare për përmirësimin e tyre.
3. I propozon Ministrisë dhënien e licencave, si dhe ndjek zbatimin e kërkesave të këtij ligji nga ofruesit e shërbimeve postare.
4. Ndjek zhvillimin e tregut postar dhe kushtet e ofrimit të shërbimit universal, dhe mbështetur në to, rishikon madhësinë e zonës së rezervuar dhe propozon masat për kufizimin e saj gradual dhe të kontrolluar në të ardhmen.
5. Ushtron kontroll mbi veprimtarinë e operatorit publik të postave në fëmijët që kanë të bëjnë me kushtet e ushtrimit të licencës së lidhur për sigurimin e shërbimit univerzalë.
6. Miraton tarifën për shërbimin univerzal dhe shërbimin e rezervuar që ofron operatori publik.
7. Mbledh nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve, që i nënshtrohen këtij ligji, çdo informacion të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të veta dhe publikon ato informacione, kur ato lidhen me ecurinë e përgjithshme të postave në Kosovë.
8. Bashkërendon veprimtaritë me karakter ndërkombëtar si dhe bashkëpunon me administratat e vendeve të tjera, në koordinim me UNMIK-un.

KREU III SHËRBIMET POSTARE

Neni 8

Dërgesat, veprimtaritë dhe shërbimet postare

8.1. Dërgesat postare përfshijnë:

- a) korrespondencën: letrat, kartpostalet, shtypshkrimet, mostrat, literaturën për të verbërit, paketat e vogla;
- b) kolipostën;
- c) telefaksin;
- d) urdhërpagesat.

8.2. Veprimtaria postare përfshin:

- a) prodhimin, emetimin, vënien në qarkullim dhe tërheqjen nga qarkullimi i pullave postare dhe të dërgesave të lidhura me to;
- b) pranimin, përpunimin, dërgimin dhe shpërndarjen e dërgesave postare.

8.3. Veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin 8.2. (a) të këtij neni, do të ushtrohen nga Ministria, që e mbulon këtë veprimtari. Veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin 8.2. (b) të këtij neni, do të ushtrohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji, në bazë të marrëveshjes, gjegjësisht licencës përkatëse.

8.4. Veprimtaritë postare të përcaktuara në paragrafin 8.2 (a) të këtij neni, të cilat ushtrohen rregullisht kundrejt një pagese, do të tarifohen si shërbime postare.

8.5. Përveç veprimtarive postare të paraqitura në paragrafin 8.2 të këtij neni, Operatori Publik i Postave ushtron edhe veprimtari të tjera (disa prej të cilave kerkojnë license të vecante dhe specifike) si:

- a) shërbime financiare dhe bankare;
- b) veprimtari sigurimi;
- c) shërbime të transportit dhe të shpërndarjes së librave dhe të gazetave;
- d) bashkëpunime në shërbimin telegrafik dhe të transmetimit të të dhënave me operatorët që ofrojnë këto shërbime;
- e) bashkëpunime me operatorët që ofrojnë shërbime telefonike
- f) shërbimin e ndërmjetëm për qarkullimin e parave (kryerja e veprimeve bankare për llogari të tjerëve);
- g) transferime parash;
- h) shërbime të tjera.

Veprimtaritë e sipërpërmendura mund të ushtrohen vetëm nëse ushtrimi i tyre nuk dëmton standardet e ofrimit të shërbimit univerzal dhe nëse nuk janë në kundërshtim me legjislacionin, që rregullon këto shërbime.

Neni 9
Dërgesat postare që ndalohen në shërbimin postar

Ndalohet dërgimi i dërgesave postare në shërbimin postar ndërkombëtar përmbajtja e të cilave është në kundërshtim me legjislacionin e mbrendshëm dhe atë ndërkombëtar të parashikuara në konventën postare dhe rregulloren e zbatimit.

KREU IV
SHERBIMI UNIVERZAL

Neni 10
Sigurimi i shërbimit univerzal

- 10.1. Shërbimi univerzal postar i ngarkohet operatorit publik të postave nga Ministri, në emër të Qeverisë dhe në bazë të marrëveshjes që lidh me te, siç përcaktohet në nenin 13 të këtij ligji.
- 10.2. Shërbimi univerzal postar duhet t'i ofrohet çdo shfrytëzuesi në tërë territorin, me një çmim unik dhe të përballueshëm dhe me një cilësi të mirë. Shërbimi univerzal postar duhet të sigurohet për çdo ditë pune, por jo më pak se 5 ditë në javë, me përjashtim të rrethanave ose të kushteve gjeografike, që gjykohen të veçanta nga Ministri.
- 10.3. Rregullat e detajuara të ofrimit të shërbimit univerzal postar nga Operatori Publik i Postave përcaktohen në "Rregulloren e shërbimit univerzal postar", e cila miratohet nga Ministria.

Neni 11
Pulla postare

Pulla postare vihet në qarkullim me urdhër të Ministrit pas miratimit nga UNMIK-u.

Neni 12
Shërbime të rezervuara

- 12.1. Operatori Publik i Postave, që të përmbush detyrimin e shërbimit univerzal postar, duhet që në mënyrë ekskluzive të ketë të drejtën:
 - a) të autorizohet për prodhimin, emitimin, venien në qarkullim dhe tërheqjen nga qarkullimi të pullave postare dhe të dërgesave të lidhura me to;
 - b) të ketë të drejtën e transportimit të dërgesave të thjeshta të postës, si të letrave brenda vendit me peshë deri në 2 kg, poashtu edhe të dërgesave të postës direkte;
 - c) të ketë të drejtën e vendosjes së kutive postare në vendet publike;
- 12.2. Korespondenca personale dhe ajo zyrtare e shpërndarë pa pagese dhe pa ndihme të palës së tretë, nuk do të mbulohet nga zona e rezervuar.
- 12.3. Kushtet e hollësishme që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat e dhënjes së ekskluzivitetit, sipas paragrafit 12.1 (b) dhe (c) të këtij neni, përcaktohen në marrëveshjen që Ministri lidh me Operatorin Publik të Postave.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrat e operatorit publik

- 13.1. Në marrëveshjen që lidhet ndërmjet Ministrit dhe Operatorit Publik të Postave përcaktohen shërbimet që duhet ofruara si dhe të drejtat dhe detyrat e Operatorit Publik të Postave për sigurimin e shërbimit univerzal postar, që lidhen me të drejtat ekskluzive dhënë për këtë qëllim.
- 13.2. Marrëveshja lidhet në afat 15-vjeçar dhe duhet të rishikohet çdo 5 vjet, me synimin për të pasqyruar ndryshimet që burojnë nga evoluimi i tregjeve postare dhe i kushteve të përgjithshme.
- 13.3. Me marrëveshje do të rregullohet:
- a) misioni dhe orientimet strategjike të Operatorit Publik të Postave;
 - b) standardet e shërbimit dhe objektivat cilësore;
 - c) mënyrat dhe mjetet e kontrollit të kryerjes së shërbimit;
 - d) çështjet e publikimit të detajeve të shërbimit univerzal postar për kushtet dhe pikat e qasjes, si dhe të dëndurisë në pranimin dhe shpërndarjen e dërgesave postare;
 - e) procedurat e trajtimit të reklamacioneve;
 - f) objektivat financiare dhe treguesit e drejtimit;
 - g) parimet e vendosjes së tarifave për shërbimet e rezervuara (që lidhen me të drejtat ekskluzive të operatorit publik), për shërbimet univerzale postare dhe miratimi i tyre;
 - h) mënyra e mbajtjes së llogarive për të siguruar transparencën e tyre;
 - i) plani i biznesit;
 - j) politika e investimeve dhe ajo kërkimore-shkencore;
 - k) politika e zhvillimit të burimeve njerëzore;
 - l) kërkesat e bashkëpunimit teknik dhe të trafikut me ofruesit e tjerë të shërbimeve univerzale postare, për të siguruar trajtimin jodiskriminues të tyre dhe për shlyerjet e detyrimeve reciproke;
 - m) të dhënat statistikore të veprimitarisë dhe periodiciteti i tyre.

Neni 14

Bashkëpunimi në shërbimin postar

- 14.1. Operatori Publik i Postave mund të përfitoj nga veprimtaria e një bashkëpunuesi (agjenti postar) për kryerjen e shërbimeve që i janë besuar atij.
- 14.2. Agjenti postar nuk mund të ushtrojë veprimtari të tjera jopostare, të cilat bien ndesh me kushtet për përmbushjen e veprimitarisë postare.
- 14.3. Operatori përcakton kushtet me plotësimin e të cilave, agjentit postar i jepet e drejta të përdoren shprehjet "postë" dhe "postare", dhe për këte e informon Ministrinë.

Neni 15
Veprimtaritë e shërbimit

Operatori Publik i Postave duhet të informojë publikun për shërbimet që ofrohen, orarin dhe standardet e shërbimeve.

Neni 16
Situatat e jashtëzakonshme

- 16.1. Në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, të shpallur sipas dispozitave përkatëse ligjore, Ministri në propozim të Departamentit të Postave mund të kufizojë ose pezullojë përkohësisht ofrimin e shërbimit univerzal postar nga Operatori Publik i Postave.
- 16.2. Operatori Publik i Postave do të mundohet të ofrojë shërbimet postare, varësisht nga situata e jashtëzakonshme e krijuar në Kosovë.

KREU I V
Licensimi

Neni 17
Licencat për ofrimin e shërbimeve univerzale

- 17.1. Ofrimi i shërbimeve univerzale dhe atyre të rezervuara postare, bëhet në bazë të një licence që jepet nga Ministria.
- 17.2. Dhënia e licences është e kushtëzuar me:
- a) regjistrimin e pretenduesit si person juridik.
 - b) Mosekzistimin e pengesave ligjore për të ushtruar një veprimtari të tillë;
 - c) Angazhimin e aplikuesit për përmbushjen e kërkesave themelore, që kanë të bëjnë me fshehtësin, sigurinë e rrjetit postar për mallrat e rrezikshme, mbrojtjen e të dhënave, si dhe të kërkesave të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore përkatëse;
 - d) Detyrimin e tyre që të respektojnë të drejtat ekskluzive që i jepen Operatorit Publik të Postave;
 - e) Aftësinë e aplikantit për të zhvilluar veprimtari të rregullt të pa ndërprer në përputhje me licensën;
 - f) plotësimin e kushteve financiare dhe teknike të domosdoshme për ofrimin e shërbimit postar.
- 17.3. Licenca përfshin:
- a) fushën për të cilën jepet (shërbimet që përfshihen dhe shtrirja gjeografike e tyre, gjegjësisht teritori për të cilin është aplikuar);
 - b) kohëzgjatjen e licences;
 - c) të dhënat për kushtet e ofrimit dhe treguesit cilësor të shërbimit;
 - d) të dhënat për mënyrat e kompensimit, në rastet e mospërmbushjes së shërbimit dhe trajtimi i reklamacioneve.
- 17.4. Ministria përcakton procedurat e dhënies së licencave, përmbajtjen e tyre, si dhe kushtet e modifikimit, të pezullimit dhe të revokimit të licencave.
- 17.5. Mosmiratimi i dhënies së licensës shoqërohet me shpjegimet përkatëse.

Neni 18

Licencat për ofrimin e shërbimeve tjera

- 18.1. Shërbimet tjera postare, që nuk përfshihen në shërbimin univerzal postar, ushtrohen pas dhënies së licencës përkatëse nga Ministria.
- 18.2. Procedura për dhënien e licencës përcaktohet nga Ministria.
- 18.3. Një licencë mund t'i jepet një personi fizik ose juridik, i cili:
 - a) Plotëson kërkesat themelore të sekretit, të sigurisë dhe të mbrojtjes së të dhënave, si dhe respekton të drejtat ekskluzive që i jepen Operatorit Publik të Postave;
 - b) Plotëson kërkesat e nevojshme, sipas këtij ligji, për të ushtruar veprimtarinë postare;
- 18.4. Kushtet e licencës mund të ndryshohen me pëlqimin e Ministrisë dhe të ndonjë ndryshimi që pason në ligj i cili ka të bëjë me kushtet e shërbimeve univerzale.
- 18.5. Ofruesi i shërbimit është i detyruar të njoftojë Ministrinë për pezullimin dhe përfundimin e veprimtarisë së tij, të paktën 60 dite para marrjes së një veprimi të tillë.
- 18.6. Ofruesi i shërbimit duhet t'ia paraqesë tarifën për dijeni Ministrisë të paktën 30 ditë para vënies së tyre në zbatim, si dhe të japë çdo informacion që i kërkohet nga Departamenti i Postës për kryerjen e funksioneve të tij.
- 18.7. Licenca mund të përfshij edhe detyrime të shërbimit univerzal postar, në rastet kur Ministria e gjykon të nevojshme një gjë të tillë për sigurimin e këtij shërbimi

Neni 19

Pezullimi i licenses

- 19.1. Nëse poseduesi i licenses siq parashihet në nenin 13 nuk i përmbahet kushteve të dhëna në këtë ligj atëherë Ministria mund t'ia pezullojë një pjesë të licenses apo tërë licensën.
- 19.2. Ministria mund ta pezullojë licensën edhe nëse poseduesi i licenses e ndërpre punën.
- 19.3. Kushtet e pezullimit të licenses varen nga përmbushja e detyrimeve siq janë paraparë nën paragrafin 13.2 dhe 13.3 të nenit 13.

Neni 20

Kontrolli i shërbimeve postare

- 20.1. Ministria do të kontrollojë përmbushjen e shërbimeve postare sipas kërkesave të këtij ligji.
- 20.2. Ministria përcakton rregullat e detajuara për ushtrimin e kontrollit.
- 20.3. Personat fizik apo juridik që ofrojnë shërbimin postar pa licencë, Ministria i detyron të ndërpresin ofrimin e shërbimit postar dhe të paguajnë gjoben përkatëse;
- 20.4. Në rastet nga paragrafi 20.3 Ministria fillon procedurat për dhënjen e licenses përkatëse të atyre personave kur ata kërkojnë vazhdimin e ofrimit të shërbimeve postare.

- 20.5. Nëse Ministria, gjatë kryerjes së kontroleve vëren devijime të dispozitave të këtij ligji, shkelje të rregullave ligjore përkatëse, të kushteve të licences dhe të rregullores së miratuar, të cilat nuk përbëjnë veprë penale por kundërvajtje administrative, Departamenti i Postës duhet të:
- a) Vendos gjobë dhe të kërkojë nga ofruesi i shërbimit zbatimin e këtij ligji.
 - b) Pezullojë veprimtarinë e ofruesit të shërbimit;
 - c) Marrë masa për tërheqjen e licencës ose të propozojë revokimin e licences,
 - d) Zbatojë sanksionet që parashikohen në dispozita ligjore të veçanta.
- 20.6. Në rastin kur licenca tërhiqet në bazë të paragrafit 20.5 (c) të këtij neni nuk jepet licencë e re për tre vjet nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit për tërheqjen.
- 20.7. Për rastet e kundërvajtjeve administrative mbahet procesverbal nga personi i autorizuar nga Ministria të cilët propozojnë marrjen e njëjës prej masave të parashikuara në paragrafin 20.5. Vendimi ipet nga personi i autorizuar nga Ministria.
- 20.8. Kundër këti vendimi ofruesi i shërbimeve mund të bëjë ankesë te Rregullatori brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit. Brenda 30 ditëve Rregullatori duhet të merr vendim në lidhje me ankesën e palës. Kundër vendimit të Rregullatorit mund të bëhet kërkesë për vlerësimin e ligjshmëris brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të tij.
- 20.9. Ofruesi dhe pranuesi i shërbimit mund ti drejtohet gjykatës përkatëse për procedurë të mëtejme.

Neni 21

Kushtet e kontratës

- 21.1. Në përputhje me kontratën e shërbimit postar, operatorët e shërbimeve postare janë të detyruar të pranojnë, përpunojnë, dërgojnë dhe ta shpërndajë tek i adresuari çdo dërgesë postare që i përgjigjet kërkesave të paraqitura në dispozitat ligjore përkatëse, standardeve dhe rregullores të shërbimit. Operatori Publik i Postave mund të kundërshtojë plotësimin e kontratës vetëm në rastet e përcaktuara në paragrafet 21.2 dhe 21.3 të këtij neni.
- 21.2. Operatori Publik i Postave është i detyruar të refuzojë plotësimin e kontratës për çdo shërbim që përfshihet në fushën e veprimtarisë së tij nëse:
- a) Marrja përsipër e detyrimit bie ndesh me "Rregulloren e shërbimit univerzal postar" apo me marrëveshjet ndërkombëtare;
 - b) Përmbajtja e dërgesës postare nuk është në përputhje me nenin 9.
 - c) Dërgesa nuk i plotëson specifikimet, të cilat lidhen me dërgesat që i nënshtrohen shpërndarjes së kushtëzuar.
- 21.3. Dërgesat postare që përmenden në paragrafin 21.2 të këtij neni dhe kushtet e postimit të tyre do të përshkruhen dhe do të përcaktohen nga Operatori Publik i Postave në rregulloret e tij të shërbimit. Gjithashtu, Operatori Publik i Postave merrë masat e duhura për publikimin e tyre.

21.4. Operatori Publik i Postave mund të mos pranojë të lidhë një kontratë nëse:

- a) Ofrimi i shërbimit është pezulluar ose kufizuar në përputhje me nenin 17 të këtij ligji;
- b) Arsyet për ushtrimin e veprimtarisë nuk përputhen me veprimtarinë e shërbimit postar.

21.5. Për pranimin e dërgesave me destinacion jashtë kufijve të Kosovës Operatori Publik i Postave është i detyruar të paralajmërojë dërguesin për ndonjë ndalim apo kufizim për importet, që është në fuqi në shtetin e mbërritjes së të adresuarit ose në shtetet tranzite nëpër të cilat dërgesat do të kalojnë.

KREU VI

Realizimi i shërbimit postar gjerë në destinacion

Neni 22

Pranimi

- 22.1. Pranimi i një dërgese ose marrja përsipër e një shërbimi nënkupton lidhjen e një kontrate ndërmjet Operatorit Publik të Postave dhe përdoruesit.
- 22.2. Vendosja e një dërgese në një kuti postare të instaluar nga ofruesi i shërbimit për këtë qëllim, ose në një pajisje tjetër, që i shërben po këtij qëllimi, është e barazvlefshme me pranimin e kësaj dërgese.
- 22.3. Pranimi i një dërgese të regjistruar (dërgesa të postës- letrave dhe dërgesave tjera të pranuar në përputhje me shërbimet speciale të regjistrimit, të regjistrimit dhe deklarimit të vlerës- koliposta, letra dhe koliposta të postuara me vlerë të deklaruar, telefaks dhe urdhërpagesë) quhet i realizuar kur dërgesa merret në dorëzim nga Operatori Publik i Postave, i cili në të njëjtën kohë, i jep dërguesit një dëftesë pranimi.
- 22.4. Një letër dhe një kolipostë mund të postohet me një vlerë të deklaruar e cila është e kufizuar në trafikun e brendshëm dhe të jashtëm, ndërkohë që, nëse dërgesa ka si destinacion një shtet të huaj, vlera e deklaruar nuk mund të kalojë kufirin e përcaktuar nga vendi i mbërritjes dhe të bëjë të njohur publikisht në rregulloret përkatëse.
- 22.5. Pranimi i parave për t'u dërguar me poste quhet i realizuar me marrjen në dorëzim të parave nga ofruesi i shërbimit dhe dhënien e njoftimit që vërteton marrjen në dorëzim.
- 22.6. Pranimi dhe shpërndarja e dërgesave postare duhet të bëhet në përputhje të plotë me standartet e cilësive të parashikuara në direktivat e Bashkimit Europian për të arritur që ato të realizohen:
- a). Koha limit nga pranimi deri në dorëzim, D+3, 85% e dërgesave.
 - b). Koha limit nga pranimi deri në dorëzim, D+5, 97% e dërgesave.

Neni 23

Tarifat e shërbimeve postare

- 23.1. Vendosja e tarifave për shërbimet postare caktohet duke marrë parasysh kushtet e cekura më poshtë:
- a) Tarifat për shërbimet postare duhet të jenë të arsyeshme dhe të atij niveli që mundësojnë mbulimin e shpenzimeve për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në tërë teritorin
 - b) Tarifa të njejta si dhe nën kushte poashtu të njejta për tërë teritorin e Kosovës
 - c) Tarifat duhet të mbulojnë fondin e zhvillimit të Shërbimeve Postare dhe rrjetin e shërbimeve
 - d) Tarifat duhet të jenë të përshtatshme dhe të krahasueshme me vendet e Unionit Europjan dhe shtetet e ngjajshme me Kosovën.
- 23.2 Taksa postare mund të paguhet me pulla postare që janë në qarkullim, me përdorimin e makinës për frankim, me para në dorë ose me mjete të tjera ligjore të pagimit.
- 23.3. Përdorimi i makinës për frankim rregullohet me kontratën e vacantë të lidhur ndërmjet operatorit publik dhe subjektit tjetër përkatës në pajtim me kushtet e përgjithëshme për kryerjen e shërbimeve postare.
- 23.4. Per klientet potencial (te medhej) operatori publik i postave ka te drejte te beje zbritje nga tarifat baze te miratuara, duke siguruar transparence te plote për të gjithë klientet e interesuar, por kjo nuk mund të perdoret per te diskriminuar klientet e tjere.
- 23.5. Përjashtohen nga tarifat e shërbimit postar, korespondenca e të verbërve.

Neni 24

Dërgimi

- 24.1. Ofruesit e shërbimeve postare janë të obliguar të dërgojnë në mënyrë të sigurtë dërgesat e pranuar.
- 24.2. Ofruesit e shërbimeve postare janë të lirë të zgjedhin rrugën dhe mënyren e transportimit të dërgesës e cila duhet të dërgohet si e tillë.

Neni 25

Dorëzimi

- 25.1. Dërgesat postare duhet t'i dorëzohen marrësit në vendin e treguar nga dërguesi me përjashtim të rasteve kur:
- a) Marrësi mund të autorizojë të tjerët për të marrë në dorëzim dërgesat postare;
 - b) Operatori Publik i Postave mund t'i dorëzojë një dërgesë të adresuar marrësit nëse dërguesi nuk ka dhënë ndonjë instruksion tjetër, një marrësi zëvendësues (antarët e familjes) ose ta dorëzojë atë tërthorazi, siç përcaktohet në paragrafin 25.2 të këtij neni.
- 25.2. Operatori Publik i Postave do t'i dorëzojë një dërgesë postare në vend të të adresuarit një marrësi të autorizuar (dorëzim tërthor), duke shkarkuar përgjegjesinë në adresën e dhënë, kur ai dorëzim i bëhet:

- a) Njësisë ushtarake, KFOR-it
- b) Entit të vuajtjës së denimit dhe atyre të edukimit;
- c) Institucionit shëndetësor ose të prkujdesjes sociale;
- d) Hotelit, konviktit të studentëve e të ngjashme;
- e) Personi juridik.

25.3. Në vend të adresës së treguar nga dërguesi, një dërgesë mund të kthehet në zyrën e operatorit publik të postave, nëse:

- a) Dërguesi ose marrësi kanë dhënë instruksione të tilla;
- b) Asnjë person i caktuar për të marrë dërgesat nuk është gjetur në adresën e treguar nga dërguesi;
- c) Dorëzimi në adresë kufizohet nga natyra dhe përcaktimet për vlerën e disa lloje dërgesash.

25.4. Një dërgesë e paregjistruar mund të dorëzohet, duke e vendosur atë në një kuti postare, private ose në një grup kutish të vëna në adresën e treguar.

Neni 26

Rastet kur dërgesa vlerësohet i padorëzueshëm

26.1. Dërgesa postare për të cilin konstatohet se nuk mund ti dorëzohet marrësit as ti kthehet dërguesit, operatori i shërbimeve postare do ta kontrollojë me komision dhe sipas nevojës do ta hap për ta konstatuar adresën e marrësit ose të dërguesit.

26.2. Në qoftëse as në bazë të kontrollit me komision nuk mund t'i dorëzohet marrësit as t'i kthehet dërguesit, operatori do të:

- a) Asgjësojë me komision dërgesën e zakonshme (letrën, kartpostalen, shtypshkrimet etj.) kur ajo përmban vetëm njoftime me shkrim;
- b) Ruaj dërgesat e tjera një vit, duke llogaritur nga data e kontrollit me komision.
- c) Ruaj 3 vjet mandapostën për të cilën konstatohet se nuk mund të dërgohet, duke llogaritur nga data kur është konstatuar pamundësia e dorëzimit të saj.

Neni 27

Marrëdhëniet me doganën

27.1. Operatori i shërbimeve postare do t'i paraqesë autoritetit doganor për kontrollim, në prani të përfaqësuesit të vet, dërgesat e kontrollit doganor.

27.2. Dërgesat e parashikuara në paragrafin 27.1 të këtij neni që vijnë nga jashtë, do të përpunohen nga ofruesi i shërbimit, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse doganore, të përcaktuara nga autoriteti doganor, dhe bazuar në marrëveshjen e veçantë me këtë autoritet doganor.

27.3. Për dërgesat në shërbimin postar ndërkombëtar, përmbajtja e të cilës i nënshtrohet kontrollit doganor, do të veprohet sipas dispozitave doganore.

Neni 28
Përgjegjësia për plotësimin e kontratës së shërbimit postar

- 28.1. Operatori i shërbimeve postare mban përgjegjësi për përmbushjen e kontratës së shërbimit postar, përfshirë dëmtimin që i është shkaktuar dërgesës, mungesën e përmbajtjes, humbjen, si dhe vonesën e tij, në përputhje me rregullat e shërbimit si dhe përjashtimet e definuara në nenin 29.
- 28.2. Në lidhje me pagesat nëpërmjet shërbimit të urdhërpagesave, brenda dhe jashtë vendit, Operatori Publik i Postave mban përgjegjësi për atë shumë për të cilën vërtetohet me dokumente.
- 28.3. Për dëmet e shkaktuara jashtë atyre që janë parashikuar në kontratë, sikurse dhe për dëmet e shkaktuara me qëllim, nga pakujdesia ose nga një akt kriminal, Operatori Publik i Postave mban përgjegjësi në përputhje me dispozitat ligjore.
- 28.4. Në rastin e mospërmbushjes së kontratës, Operatori Publik i Postave është i detyruar të kthejë tarifen e paguar, përjashtuar dërgesat e thjeshta.

Neni 29
Rastet e përjashtimit nga përgjegjësia

Operatori Publik i Postave nuk mban përgjegjësi në fushën e shërbimit postar për:

- a) Dërgesë të thjeshtë postare;
- b) Në qoftëse operatori dëshmon se humbja apo dëmtimi i dërgesës së regjistruar ose pakësimi i përmbajtjes së saj, ose kalimi i afatit për dërgimin dhe dorëzimin e dërgesës, është shkaktuar si pasojë e shkaqeve të jashtme ose me faj të dorëzuesit.

Neni 30
Masa e dëmshpërblimit

- 30.1. Operatori publik i postave është i detyruar të paguaj dëmshpërblim në rastin e humbjes apo dëmtimit:
- a).Te dërgesave të porositura dhe kolive pa vlerë të deklaruar.
 - b).Te letrave dhe kolive me vlerë të deklaruar.
 - c).Te urdher pagesave.
- 30.2. Në rastin e dërgesave të percaktuara në pikën b), dëmshpërblimi do të jetë i barabartë me deklarin e vlerës sic është deklaruar nga dërguesi.
Në rastin e dërgesave të percaktuara në pikën a), masa e dëmshpërblimit bëhet sipas tarifave të miratuara.
Në rastin e dërgesave të percaktuara në pikën c), masa e dëmshpërblimit do të jetë e barabartë me vlerën e urdher pagesave.
- 30.3. Për shërbimin ndërkombëtar masa e dëmshpërblimit do të percaktohet në përputhje me konventën ndërkombëtare dhe me „Rregulloren e shërbimit universal postar“

Neni 31

Reklamimi

- 31.1. Afati i ankimit për dëmtshpërblim ndaj ofruesit të shërbimit, humbet pas një viti duke filluar 15 ditë pas datës së postimit.
- 31.2. Operatori publik mund të kërkojë pagimin e tarifës së shërbimit për reklamim sipas afatit të përcaktuar në kontratën e lidhur për sigurimin e atij shërbimi.

KREU VII

SEKRETI

Neni 32

Ruajtja e sekretit

- 32.1. Ofruesi i shërbimit është i detyruar të ruajë sekretin e korrespondencës, sekretin individual, sekretin e veprimtarisë, që i bëhet i njohur gjatë përmbushjes së kontratës, si dhe kujdeset për trajtimin e fshehtësisë të çdo informacioni vetjak.
- 32.2. Obligimi i ruajtjes së sekretit është i njëjtë për ofruesin e shërbimit, për të gjithë punonjësit e tij, si dhe për çdo njeri tjetër që ka dijeni për sekretet individuale ose hollësitë vetjake, për të cilat ka mësuar gjatë punës ose në ndonjë mënyrë tjetër. Kur zbulohet sekretet vetjak, personat përgjegjës mbajnë përgjegjësi në përputhje me dispozitat ligjore.
- 32.3. Obligimi për ruajtjen e sekretit, siç përcaktohet në paragrafin 32.2 të këtij neni, do të zbatohet edhe pas përfundimit të shërbimit postar, si dhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve përkatëse të punës ndërmjet ofruesit të shërbimit dhe punonjësit.

Neni 33

Mbrojtja e të dhënave

- 33.1. Bazuar në obligimet për ruajtjen e sekretit, ofruesit të shërbimit, me përjashtimet e bëra në rastet e përcaktuara në paragrafin 33.2 të këtij neni, i ndalohe të:
 - a) Hapë një dërgesë postare të mbyllur ose të njihet me përmbajtjen e tij pa e hapur dërgesën;
 - b) Japë të tjerëve të dhëna me të cilat ai është njohur gjatë përmbushjes së shërbimit, me përjashtim të dërguesit, të adresuarit dhe personit të autorizuar për të marrë dërgesën në dorëzim;
 - c) Dorëzojë dërgesën te të tjerët, me qëllim njohjen e përmbajtjes së tij;
 - d) Informoj të tjerët rreth përmbushjes së shërbimit, përveç dërguesit, marrësit dhe personit të autorizuar për të marrë dërgesën në dorëzim.
- 33.2. Ofruesi i shërbimit mund të hapë një dërgesë postare të mbyllur ose të shqyrtoj përmbajtjen e një dërgese postare të hapur nëse:
 - a) Për shkak të mungesës së adresës, dërgesa nuk mund të dorëzohet apo të kthehet dhe për dorëzimin e tij është e nevojshme të njihet adresa e marrësit ose e dërguesit;
 - b) Paqetimi i dërgesës është dëmtuar në atë masë që për t'u mbrojtur përmbajtja e tij, është i nevojshëm ripaqetimi i cili nuk mund të bëhet pa hapjen e dërgesës;

- 33.3. Hapja e një dërgese do të bëhet duke mbajtur procesverbal për procedurën e hapjes dhe për masat që duhen marrë. Hapja mund të realizohet në praninë e një personi të autorizuar të postës dhe fakti i hapjes duhet të tregohet mbi dërgesë, por duhet informuar dërguesin ose marrësin për hapjen dhe për arsyet e kësaj hapjeje.
- 33.4. Ndalimet e parashikuara në paragrafin 33.1 (b), (c) dhe (d) të këtij neni, nuk do të zbatohen nëse në bazë të urdhërit të gjyqit, veprimet e kryera në to janë të domosdoshme, për ndjekjen e një kundërvajtjeje administrative ose të një vepre penale.
- 33.5. Në lidhje me konfiskimin, rezervimin apo sekuestrimin e dërgesave postare do të zbatohen dispozitat ligjore përkatëse.

KREU VIII KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 34 Rastet e kundërvajtjeve

Dënohen si kundërvajtje administrative, të kryera nga një person fizik ose juridik, kur nuk përbejn vepër penale, shkeljet e mëposhtme:

1. Dërgimi i dërgesave postare pa licencë siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji.
2. Mosrespektimi i kushteve të licencës të parashikuara në nenet 17 dhe 18 të këtij ligji.
3. Shkelja e dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me fshehtësinë, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave.
4. Mosrespektimi i të drejtave ekskluzive të operatorit publik të postave, sipas parashikimeve të këtij ligji.
5. Veprimi në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 dhe 7 të këtij ligji.

Neni 35 Masa e gjobës

- 35.1. Kundërvajtjet administrative do të ndëshkohen krahas masave të parashikuara në nenin 20 pikat 3 dhe 4 të këtij ligji, me gjobë në masat si vijon:
- a) Për kundërvajtjet administrative sipas nenit 34 paragrafet 1, 3 dhe 4, në masën pesë deri në dhjetë herë të shumicës së pagesës për marrjen e licences.
 - b) Për kundërvajtjet administrative sipas nenit 34 paragrafi 2, në masën dy deri në pesë herë të shumës së pagesës për marrjen, përkatësisht, të licences.
 - c) Për kundërvajtjet administrative sipas nenit 34 paragrafi 5, në masën e shumës së pagesës për marrjen e licences.
- 35.2. Denimi me gjobë dhe masa e saj vendosen nga udhëheqësi i Departamentit të Postës. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankimi, sipas parashikimit në nenin 20 paragrafi 8 të këtij ligji.
- 35.3. Për zbatimin e kërkesave të këtij neni Ministri bashkëpunon me organet përkatëse. Të ardhurat nga gjobat kalojnë në buxhetin e Kosovës.

KREU IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 36

Shërbimi univerzal postar, mbajtja dhe zhvillimi i tij sigurohen, në rast nevoje, edhe me mbështetje nga Qeveria përmes masave investuese.

Neni 37

Në planin e zhvillimit komunal dhe rajonal, Operatori Publik i Postave bashkëpunon me organet autoritative vendore për krijimin e mundësive për vendosjen e ndërtesave dhe të pajisjeve që i shërbejnë sigurimit të shërbimeve univerzale, si dhe të lehtësive për përdorimin e hapësirave publike, detyrimin për vendosjen e kutive postare në ndërtesa dhe në vendbanimet private, si dhe administrimin e sistemit të adresave.

Neni 38

Operatori Publik i Postave obligohet për të përdorur emblemen e postës.

Neni 39

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha dispozitat e tjera ligjore e nën ligjore që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 40

Ministria për zbatimin e këtij ligji nxjerr akte përkatëse nënligjore.

Neni 41

Ky ligj hynë në fuqi pasi të jetë miratuar nga Kuvendi i Kosovës, nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallur nga PSSP-ja .

**Ligji Nr.2003 / 18
9 Tetor 2003**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci